NEWSLETTER

SHKURT 2026

# UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

## Monitorim i avancuar i cilësisë së ujërave

**Projekti AMORE-AL** nuk është vetëm një model monitorimi, por një hap vendimtar drejt vendosjes së standardeve evropiane për menaxhimin e ujërave dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

## Prezantohen rezultatet e dy viteve të projektit

**Universiteti Bujqësor i Tiranës** prezantoi rezultatet e dy viteve të projektit AMORE-AL, i cili ka instaluar sistemin e parë automatizuar afatgjatë të monitorimit të cilësisë së ujit në lumin Ishëm, duke mbledhur të dhëna reale për disa parametra dhe duke përdorur modele shkencore si MoRE për të identifikuar burimet e ndotjes dhe emetimet në basen. **Lexo më shumë...**

Po ashtu, UBT mori pjesë në workshop-in e projekteve EU4Rivers dhe AMORE-AL për forcimin e kapaciteteve në monitorimin dhe menaxhimin e ujërave. **Lexo më shumë...**

# AMoRE-AL në basenin e Lumit Ishëm Nga simbol i ndotjes në model të monitorimit modern

**Projekti AMoRE-AL** prezanton në Shqipëri një metodë të avancuar për vlerësimin e ndotjes në lumenj, duke kombinuar monitorimin afatgjatë me teknologjinë LVS, modelimin shkencor MoRE dhe analiza laboratorike, për të siguruar të dhëna të sakta dhe bazë për politika mjedisore efektive

Koordinatorët e projektit AMoRE-AL janë *Prof. Dr. Seit Shallari* nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, i cili drejton zbatimin në Shqipëri, si dhe partnerët ndërkombëtarë *Prof. Dr. Thomas Ertl* nga BOKU në Vjenë, *Prof. Matthias Zessner* nga TU Wien dhe P*rof. Dr. Stephan Fuchs* nga Karlsruhe Institute of Technology.

Në kuadër të projektit, po monitorohen ujërat sipërfaqësore të lumit Ishëm përmes 9 stacioneve dhe analizave fiziko-kimike, organike dhe farmaceutike, duke përdorur pajisje të specializuara. Tre studiues të rinj nga Universiteti Bujqësor i Tiranës po zhvillojnë doktoraturën në kuadër të projektit, duke forcuar dimensionin akademik dhe perspektivën afatgjatë të kërkimit shkencor në menaxhimin e ujërave. Qëllimi i projektit është vlerësimi i ndotjes, identifikimi i burimeve të saj dhe ndërtimi i një inventari kombëtar, duke kontribuar në hartimin e Planit të Menaxhimit të Basenit dhe duke kthyer sfidat mjedisore në mundësi për zhvillim të qëndrueshëm. **Lexo më shumë...**

# UBT nënshkruan marrëveshje të rëndësishme bashkëpunimi

**Laboratori i parë në Shqipëri** dedikuar analizimit të llumit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, pritet të ngrihet së shpejti dhe të akreditohet sipas standardeve kombëtare dhe europiane.

Universiteti Bujqësor i Tiranës finalizoi marrëveshjen strategjike të bashkëpunimit me AKUK, me mbështetje financiare dhe teknike nga **GIZ Albania**. **Lexo më shumë...**

**Një etapë e re bashkëpunimi akademik** mes UBT dhe Universitetit të Prishtinës, hap rrugën për partneritete të përbashkëta në kërkim shkencor, inovacion, mobilitete akademike etj.
Marrëveshja parashikon . **Lexo më shumë...**

Firmoset në UBT Memorandum Bashkëpunimi për nismën **"Safe Paws Albania"**, që synon përmirësimin e mirëqenies së kafshëve dhe mbrojtjen e shëndetit publik.
Nisma bashkon institucione dhe organizata kombëtare e ndërkombëtare dhe do të zbatohet në Tropojë, ku parashikohet trajtimi i 150–300 kafshëve rrugësh me shërbime të specializuara. **Lexo më shumë...**

Bashkëpunimi me **Western Balkans University**, zgjeron partneritetet akademike dhe shkencore të UBT-së.
*Marrëveshja u nënshkrua nga Rektori i UBT-së, Prof. Dr. Fatbardh Sallaku, dhe Rektori i WBU, Prof. Dr. Ferdinand Gjana*. **Lexo më shumë...**

## Projekti STARTUP10

*Prof. Dr. Erinda Lika* udhëhoqi me sukses rolin e Focal Point

Zëvendës Rektorja për Shkencën dhe Projektet në Universiteti Bujqësor i Tiranës, **Prof. Dr. Erinda Lika,** udhëhoqi me sukses rolin e **Focal Point në projektin ndërkombëtar STARTUP10,** duke koordinuar proceset në nivel institucional dhe kombëtar.

Ajo siguroi menaxhimin transparent dhe meritokratik të thirrjeve kombëtare, si dhe përzgjedhjen e **startup-eve** mbi baza të qarta vlerësimi, duke kontribuar në forcimin e mbështetjes për sipërmarrjet inovative dhe bashkëpunimin ndërinstitucional. **Lexo më shumë...**

## Workshop i përbashkët Rajonal për Inovacionin dhe Kërkimin UBT-Polis

Universiteti Bujqësor i Tiranës, në bashkëpunim me Universiteti Polis, bashkë-organizoi workshopin rajonal "Inovacion sot për një të ardhme evropiane në Ballkan".

Aktiviteti mblodhi bashkë akademikë dhe ekspertë nga rajoni dhe Europa për të diskutuar rolin e universiteteve në zhvillimin e inovacionit dhe kërkimit.

Rektori **Prof. Dr. Fatbardh Sallaku** theksoi rëndësinë e ndërkombëtarizimit, ndërsa *Prof. Dr. Erinda Lika* dhe *Prof. Dr. Endrit Kullaj* prezantuan reformat në shkencat e jetës dhe vizionin për digjitalizimin e bujqësisë. **Lexo më shumë...**

## Klinika e Kafshëve të Shoqërimit në UBT tashmë është më pranë komunitetit

*Klinika  e Kafshëve të Shoqërimit* ofron një gamë të plotë shërbimesh veterinare, konsulta profesionale dhe kujdes të specializuar për kafshët.

Ajo shërben njëkohësisht si hapësirë praktike mësimore për studentët e Fakultetit të Mjekësisë Veterinare, të cilët, nën mbikëqyrjen e stafit akademik, angazhohen çdo ditë në trajtimin e rasteve klinike dhe aktivitete profesionale.

Së fundmi, klinika është bërë e aksesueshme edhe në rrjetet sociale përmes faqes: @klinika_veterinare_ubt

## UBT kontribuon në Projektin- Pilot në Parkun Kombëtar të Dajtit

Universiteti Bujqësor i Tiranës, si partner në projektin **BauNOW** (Interreg Euro-MED, bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian), ka zhvilluar një aksion pilot në Parku Kombëtar i Dajtit me qëllim promovimin e Tranzicionit të Gjelbër dhe të Drejtë. Aksioni kombinon mbrojtjen e biodiversitetit me mobilitetin e qëndrueshëm, eficiencën energjetike dhe edukimin e vizitorëve.

Në të njëjtën kohë, projekti ka përfshirë angazhimin e palëve të interesit përmes eventeve publike, rrjetëzimit me partnerë dhe bizneset lokale. **Lexo më shumë...**




**“I LOVE UBT”**

*Prezantohet instalacioni i studentëve*

Një projekt kreativ i realizuar nga studentët e vitit të tretë të Dizajnit të Mobiljeve u prezantua në ambientet e Rektoratit.

Instalacioni prej druri **“I LOVE UBT”** simbolizon lidhjen dhe përkatësinë e studentëve me universitetin, duke u kthyer në një element identitar për të gjithë komunitetin universitar.

Ai është konceptuar si një pikë referimi dhe hapësirë rekreative, instalacioni dhe si ambient bashkëpunimi e relaksi për studentët. **Lexo më shumë...**




## UBT mirëpret maturantët e shkollave “Gramoz Palushi” dhe “Aleks Buda”

Nxënësit e Shkollave të Mesme “Gramoz Palushi” dhe “Aleks Buda” nga Tirana vizituan kampusin e UBT.

Maturantët u njohën me ofertën akademike, panë nga afër mjediset mësimore, laboratorët modernë dhe ambientet që mbështesin mësimdhënien, si dhe me mundësitë e punësimit pas diplomimit. **Lexo më shumë...**

*Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun* dhe Zyrat e Karrierës i orientuan maturantwt pwr programet e UBT, praktikat profesionale, bashkëpunimet ndërkombëtare, dhe veçanërisht **partneritetin strategjik me BOKU Vienna.** **Lexo më shumë...**

## Studentë ndërkombëtarë zgjedhin të studiojnë në UBT

**Xhulia Grecco** nga Italia, ka zgjedhur UBT, në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, për të ndjekur ëndrrën e saj akademike dhe për të zhvilluar pasionin për kujdesin ndaj kafshëve.

Çdo ditë Xhulia ushtrohet në Klinikën e UBT duke u praktikuar më shumë për profesionin e të ardhmes së saj si veterinere.

Historia e saj është një burim i vërtetë frymëzimi për të gjithë studentët... **Lexo më shumë...**

## Nga auditorët e UBT në skenën kombëtare

*Rrugëtimi artistik i Ibrahim Rrustemajt*

**Ibrahim Rrustemaj**, student i vitit të parë në programin **Inxhinieri Mjedisi** në UBT, tregon se studentët mund të shkëlqejnë jo vetëm në mësime, por edhe në aktivitetet artistike dhe kulturore.

Ai mban rolin e Drejtorit Artistik në shfaqjen ***"Legjenda e Valles Shqiptare – Besim Zekthi, Nderi i Kombit",*** të organizuar nga Ansambli i Këngëve dhe Valleve "Qemal Stafa", në 90-vjetorin e lindjes së artistit të madh. **Lexo më shumë...**

## Studentët e UBT-së, përfitues të bursave të programit Erasmus+

Përmes programit Erasmus+, Universiteti Bujqësor i Tiranës, ka mundësuar që prej vitit 2021 qindra studentë të ndjekin studime në universitete europiane.

Vetëm në vitin akademik 2024–2025, rreth 120 studentë zhvilluan një semestër mobiliteti në vende të ndryshme të Europës, duke fituar përvojë akademike, profesionale dhe ndërkulturore.

Kjo dëshmon angazhimin e UBT-së për ndërkombëtarizimin dhe afrimin me standardet europiane të arsimit të lartë. **Lexo më shumë...**

## Projekti "Studio 4", Arkitekturë Peizazhi për rivitalizimin urban

"Studio 4"në programin Bachelor të Arkitekturës së Peizazhit u përmbyll me prezantimin e projekteve të studentëve të vitit të tretë, të fokusuar në rivitalizimin urban. Studentët eksploruan zgjidhje të integruara për hapësirat urbane, duke kombinuar infrastrukturën e gjelbër dhe blu me qasje bashkëkohore të dizajnit të peizazhit. **Lexo më shumë...**

Studio shërbeu si një laborator praktik nga analiza deri te propozimet konkrete hapësinore, duke nxitur kreativitetin dhe zhvillimin profesional të studentëve.